

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik



Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

TRIMED

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

K51612031J

NUIS/NIPT

Autostrada Tirane -Durres , Km 10, Zone Kadastrale 2105, Nr.Pasurie 95/11.

Adresa

Tiranë

Albania

1051

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0694091371

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

finance@trimed.com.al

E-mail

Administrator Gentiana Peshkatari

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2025/07/16

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

+355692092330

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-53828-07-07-2025

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open INT

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.

Drejtoria e Spitalit Rajonal Durres

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

31999583

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

:“Blerje materiale Ortopedike” për nevojat e Spitalit Rajonal Durres

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2025/08/07

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Mallra

Data e zhvillimit të procedurës

2025/08/07

Numri i njoftimit

REF-53828-07-07-2025

Kodi CPV

33141700-7

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligj nr.162 dt. 23.12.2020 Per Prokurimin Publik (i ndryshuar)

- VKM. Nr. 285, datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK1 (i ndryshuar)

- DST.

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

☒

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

☐

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

☐

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

☐

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

Me date 08.07.2025 nga Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Spitalit Rajonal Durres eshte publikuar procedura e prokurimit me objekt: “Blerje materiale Ortopedike” per nevojat e Spitalit Rajonal Durres, me fond limit 31,999,583.33 leke pa tvsh, me numer REF-53828-07-07-2025.

Operatori ekonomik “TRIMED” sh.p.k eshte i interesuar per te marre pjese ne kete procedure prokurimi.

Pasi shqyrtuam në menyrë të detajuar “Kriteret & Specifikimet Teknike” per kete procedure prokurimi, konstatojme se, nga ana e autoritetit kontraktor në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, per artikujt e meposhtem jane percaktuar keto specifikime teknike:

? Per artikullin Endoproteza parciale mono- bllok ose Austin Moore, jane percaktuar keto specifikime teknike: Proteza parciale mono-bllok duhet të ketë stemin 130- 150mm të gjatë me kënd 135 gradë dhe të fillojnë nga përmasa 38mm deri në 55mm. Materiali mund te jete stainless steel. Deviacion +/- 10%.

? Per artikullin Tel per sinteze jane percaktuar keto specifikime teknike: ?1.5mm, ?1.8mm, ?2.0mm.

Gjithashtu nga ana e Autoritetit Kontraktor tek kriteret e vecanta te kualifikimit:

Ne piken 2.3.6 kerkohet:

Autorizim nga prodhuesi i mallrave, (ose distributori i autorizuar prej prodhuesit) i perkthyer dhe i noterizuar, per artikujt per te cilin oferton operatori ekonomik, nëpërmjet te cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtoje artikujt e kerkuara ne specifikimet teknike, te perkthyer dhe noterizuar. Ne rast se operatori ekonomik eshte vet prodhuesi duhet te paraqese vetdeklarim me shkrim..

? Konstatuam se në këtë procedurë mungon kriteri i paraqitjes se mostrave për të gjithë artikujt e ofruar, kriter ky që Autoriteti Kontraktor, Spitali Rajonal Durrës, në të gjitha procedurat e zhvilluara gjatë viteve të kaluara për të njëjtin objekt prokurimi – “Blerje materiale ortopedike” e ka përcaktuar si kriter të detyrueshëm që në momentin e dorëzimit të ofertave.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Me date 08.07.2025 nga Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Spitalit Rajonal Durres eshte publikuar procedura e prokurimit me objekt: “Blerje materiale Ortopedike” per nevojat e Spitalit Rajonal Durres, me fond limit 31,999,583.33 leke pa tvsh, me numer REF-53828-07-07-2025.

Operatori ekonomik “TRIMED” sh.p.k eshte i interesuar per te marre pjese ne kete procedure prokurimi.

Pasi shqyrtuam në menyrë të detajuar “Kriteret & Specifikimet Teknike” për këtë procedurë prokurimi, konstatojmë se, nga ana e autoritetit kontraktor në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, për artikujt e mëposhtem janë përcaktuar këto specifikime teknike:
? Për artikullin Endoproteza parciale mono- bllok ose Austin Moore, janë përcaktuar këto specifikime teknike: Proteza parciale mono-blllok duhet të ketë stemin 130- 150mm të gjatë me kënd 135 gradë dhe të fillojë nga përmasa 38mm deri në 55mm. Materiali mund të jetë stainless steel. Deviacion +/- 10%.

? Për artikullin Tel për sintezë janë përcaktuar këto specifikime teknike: ?1.5mm, ?1.8mm, ?2.0mm.

? Konstatuam se në këtë procedurë mungon kriteri i paraqitjes së mostrave për të gjithë artikujt e ofruar, kriter ky që Autoriteti Kontraktor, Spitali Rajonal Durrës, në të gjitha procedurat e zhvilluara gjatë viteve të kaluara për të njëjtin objekt prokurimi – “Blerje materiale ortopedike” e ka përcaktuar si kriter të detyrueshëm që në momentin e dorëzimit të ofertave.

Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2021 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Referuar Nenit 36 “Specifikimet teknike”, i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

?

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”

Në pikën 2 të nenit 40 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara”.

Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë specifikime teknike që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës duke dhënë informacion të plotë me qëllim që operatorët ekonomikë të kenë informacion të qartë dhe të saktë në lidhje me përgatitjen e ofrave të tyre. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, njësia e prokurimit, në varësi të fondit limit dhe rëndësisë që ka procedura, përcakton kërkesat për artikujt që kërkon të prokurojë, duke i përshkruar gjithashtu cilësitë në varësi edhe të funksionit të artikujve të caktuar. Është në të drejtën e AK të kërkojë artikuj cilësorë, por gjithmonë duke studiuar tregun, për të përcaktuar qartë përshkrimet e mallrave të cilat AK i konsideron më të përshtatshëm për punën e tyre.

Autoriteti kontraktor në përgatitjen e DST-ve, duhet të argumentojë specifikimet teknike, me qëllim që t’u vijë në ndihmë operatorëve ekonomikë në përgatitjen e ofertave të tyre. Në asnjë rast AK

nuk duhet të bëhet pengesë apo të vendosë kërkesa të panevojshme apo të pasakta, që jo vetëm nuk ndihmojnë, por vështirësojnë pozitat e operatorëve ekonomikë.

Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. Parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë.

Autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike duhet të evitojë përcaktimet fikse sikundër në rastin konkret pasi të dhënat fikse çënojnë konkurrencën dhe janë diskriminuese për operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentesh me qëllim përfitim të një malli apo shërbimi me performancë të lartë e me çmim të ulët. Autoritetit kontraktor nuk duhet të vendosë ato specifikime teknike për realizimin e shërbimit objekt-prokurimi, të cilat bien ndesh me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik apo me parashikimet e nenit 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik.

Specifikimet teknike të sakta dhe të plota ndihmojnë nga njëra anë operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave dhe nga ana tjetër autoritetin kontraktor në realizimin e procedurës së prokurimit në kohën e duhur.

APP me Rekomandimin nr. 2055/4 Prot. date 09.01.2025 ne lidhje me specifikimet teknike eshte shprehur:

? Autoritetet kontraktore duhet te argumentojne specifikimet teknike per objektin e prokurimit, konform parashikimeve te nenit 78 te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 285, date 19.05.2021 Per miratimin e rregullave te prokurimit publik , i ndryshuar.

? Specifikimet teknike nuk duhet te hartohen me parametra fikse ose me nje interval minimal. Ne baze te nenit 36 te LPP, vendosja e specifikimeve ne kete menyre mund te orientoje ofertuesit drejt markave specifike prodhuese ose drejt distributoreve specifik te mallrave apo mund te behet pengese per pjesemarrje.

? Autoritetet kontraktore duhet te percaktojne dokumente konkrete, ne permbushje te kerkesave teknike te percaktuara, me qellim qe operatoret ekonomike te provojne permbushjen e tyre.

? Njekohesisht, autoriteti kontraktore duhet te mbajne ne konsiderate se, specifikimet teknike duhet te pergatiten per te pershkruar sa me sakte dhe ne menyre te plote objektin e prokurimit. Ne kete kuptim, aty ku eshte e nevojshme, duhet te percaktojne specifikime konkrete per zera te preventivit, duke pershkruar teresine e kerkesave ne lidhje me procesin e punes qe do te realizohet per keta zera. Nisur nga sa me siper kerkojme nga Autoriteti Kontraktor modifikimin e dokumentave te tenderit, per specifikimet teknike/kriteret si me poshte:

Pretendimi nr 1.

Ishte

? Artikulli Endoproteza parciale mono- bllok ose Austin Moore. Specifikime teknike: Proteza parciale mono-blok duhet te ketë stemin 130- 150mm të gjatë me kënd 135 gradë dhe të fillojnë nga përmasa 38mm deri në 55mm. Materiali mund te jete stainless steel. Deviacion +/- 10%.

Te behet:

Me qëllim mbrojtjen e shëndetit të pacientëve dhe garantimin e trajtimeve ortopedike bashkëkohore, kerkojme qe te përjashtohet përdorimi i protezës së tipit Austin Moore, pasi:

? Bëhet fjalë për një teknologji të vjetruar që nuk ofron mundësi të personalizimit gjatë ndërhyrjes kirurgjikale;

? Nuk lejon modifikime intraoperatore, gjë që rrit ndjeshëm rrezikun e mos-përshtatjes me anatomicën e pacientit;

? Në rastet e komplikacioneve ose revizionit, kjo protezë ka treguar një përqindje më të lartë të dështimeve dhe komplikacioneve të pakthyeshme (përfshirë dëmtime të mëdha të strukturave kockore dhe nevojë për ndërhyrje të mëtejshme);

? Përdorimi i saj nuk përputhet me praktikatat moderne ortopedike, as me standardet bashkëkohore ndërkombëtare të mjekësisë ortopedike.

Prandaj kerkojme qe te hiqet proteza Austin Moore.

Mbeshtetja ligjore dhe teknike:

- Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili lejon përcaktimin e specifikimeve teknike që lidhen me sigurinë e objektit të prokurimit;

- Principi i sigurisë mjekësore dhe mbrojtjes së pacientit, i sanksionuar edhe në udhëzimet klinike kombëtare dhe ndërkombëtare në ortopedi;

- Standardet e Agjencive Evropiane të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (EMA, MDR 2017/745), të cilat rekomandojnë pajisje të përshtatshme me strukturën individuale të pacientit dhe revizionim të lehtë.

Nisur nga sa me siper kerkojme nga Autoriteti Kontraktor qe artikulli Endoproteza Parciale monoblok ose Austin Moore të rikonceptohet, te behet si me poshte:

Endoproteza parciale mono- bllok. Specifikime teknike: Proteza parciale mono-blok duhet të ketë stemin 130- 150mm të gjatë me kënd 135 gradë dhe të fillojnë nga përmasa 38mm deri në 55mm.

Materiali mund te jete stainless steel. Deviacion +/- 10%.

Pretendimi nr 2.

Ishte

Artikulli Tel per sinteze. Specifikime teknike: ?1.5mm, ?1.8mm, ?2.0mm.

Te behet:

Nisur nga fakti qe sa sasia e kerkuar per kete artikullin Tel per sinteze ne proceduren konkrete te prokurimit eshte cope 1, mendojme se specifikimet teknike per kete artikull duhet te jene: ?1.5mm ose ?1.8mm ose ?2.0mm sepse nese i referohemi specifikimeve te percaktuara ?1.5mm, ?1.8mm, ?2.0mm, për të përmbushur këtë kriter duhet te paraqesim 3 cope, jo 1 (nje) sic percaktohet tek sasia e kerkuar nga AK, dhe kerkojme te kete nje Deviacion +/- 10%.

Referuar ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, specifikimet teknike të një procedure prokurimi duhet të jenë koherente, objektive dhe të justifikuara.

Në procedurat e mëparshme për të njëjtin objekt prokurimi – “Blerje materiale ortopedike” – Autoriteti Kontraktor ka parashikuar si specifikime teknike diametra alternative: ?1.5mm ose ?1.8mm ose ?2.0mm. Ndryshimi i këtyre specifikimeve në një procedurë të re, pa një arsyetim të qartë dhe teknik, përbën mungesë koherence dhe mund të cenojë barazinë në trajtim, konkurrencën dhe transparencën në procesin e prokurimit.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor ka detyrimin të ruajë koherencën me praktikën e mëparshme, përveç rasteve kur ka ndryshime të justifikuara mbi bazë të nevojave reale ose të zhvillimeve teknike të provuara.

Autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike duhet të evitojë përcaktimet fikse sikundër në rastin konkret pasi të dhënat fikse çenojnë konkurrencën dhe janë diskriminuese për operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentesh me qëllim përfitimin e një malli apo shërbimi me performancë të lartë e me çmim të ulët. Autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë ato specifikime teknike për realizimin e shërbimit / furnizimit objekt-prokurimi, të cilat bien ndesh me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik apo me parashikimet e nenit 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik.

Prandaj kërkojmë nga Autoriteti Kontraktor që specifikimet teknike për artikullin Tel për sinteze të behen si me poshte:

Tel për sinteze. Specifikime teknike: ?1.5mm ose ?1.8mm ose ?2.0mm.
+/- 10%.

Deviacion

Pretendimi nr 3.

Ishte:

Nga ana e Autoritetit Kontraktor tek kriteret e vecanta të kualifikimit, ne piken 2.3.6 kërkohej:

? Autorizim nga prodhuesi i mallrave, (ose distributori i autorizuar prej prodhuesit) i perkthyer dhe i noterizuar, për artikujt për të cilin oferton operatori ekonomik, nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë artikujt e kërkuara në specifikimet teknike, të perkthyer dhe noterizuar. Në rast se operatori ekonomik është vet prodhuesi duhet të paraqesë vetdeklarim me shkrim..

Kërkesa e Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave, (ose distributori i autorizuar prej prodhuesit) i perkthyer dhe i noterizuar, për artikujt për të cilin oferton operatori ekonomik, nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë artikujt e kërkuara në specifikimet teknike, të perkthyer dhe noterizuar, është një kriter i ekzagjeruar, kufizues dhe në kundërshtim me Ligjin nr.162 dt. 23.12.2020 Për Prokurimin Publik (i ndryshuar); VKM. Nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik1 (i ndryshuar) dhe me njoftimin e APP nr.5707/5 Prot. Date 02.02.2024.

Vendosja e këtij kriteri shkon përtej arritjes së synimit të kërkuar nga AK, sepse Prodhuesi i mallrave, (ose distributori i autorizuar prej prodhuesit), për artikujt që disponojnë leshojnë autorizim për Operatorët Ekonomikë që të tregtojnë këto artikujt, dhe për të vertetuar përmbushjen e specifikimeve teknike dergojnë Kataloge në të cilat përcaktohen specifikimet teknike për të gjitha artikujt, pra nuk është e nevojshme që të përcaktohen në Autorizim specifikimet teknike siç kerkohen nga AK në rastin konkret, ky është kriter që shkon përtej asaj cka është e domosdoshme për autoritetin kontraktor, për të verifikuar përmbushjen e këtij kriteri.

Autoriteti kontraktor në vendosjen e këtij kriteri, kufizon numrin e pjesëmarrësve, duke ulur konkurrencën dhe duke sjellë pabarazi në rrethin e ofertuesve të interesuar për këtë procedurë prokurimi.

Kriteri i mësipërm ka shkelur një ndër parimet e rëndësishme, atë të mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, parim i cili është një parakusht sine qua non i realizimit të objektit dhe qëllimit të vetë ligjit për prokurimin publik, atë trajtimit të barabartë dhe

jodiskriminues të operatorëve ekonomikë, si edhe të sigurimit të integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik.

Autoriteti kontraktor gjatë hartimit të kriterit të dokumenteve të prokurimit objekt-ankimi, duhet të kishte pasur parasysh parashikimet ligjore e konkretisht, neni 2 dhe neni 3 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

Ky kriter i hartuar nga autoriteti kontraktor, duke mos iu referuar dispozitave në fuqi lidhur me pajisjen me autorizimit të lëshuar nga prodhuesi ose distributor i autorizuar, është në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Kriteret e kualifikimit, nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim kryerjen e një vlerësimi të drejtë dhe jo diskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi. Mospërcaktimi i saktë i kriterit, shkel parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, nxitjes së konkurrencës dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit.

Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Po në këtë kriter nga ana e Autoritetit Kontraktor është përcaktuar :

? Autorizim nga prodhuesi i mallrave, (ose distributori i autorizuar prej prodhuesit) i perkthyer dhe i noterizuar....

Ne piken 3 te kriterave percaktohet:

? Vetedeklarim se te gjitha materialet ortopedike nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) jane te certifikuara/ markuara CE / FDA ose ekuivalente me to, të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave. I shoqeruar me kopjet e certifikatave perkatese te perkthyer dhe te noterizuara.

Kjo procedure eshte Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar, referuar në nenin 24 të VKM Nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 2, përcaktohet: “Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht.

Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht...

Me VKM nr.498 date 01.08.2024, per disa shtesa dhe ndryshime ne VKM Nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ne nenin 9, percaktohet:

Operatoret ekonomike mund te paraqesin ofertat e tyre ne gjuhen shqip ose anglisht. Nje oferte eshte e kualifikueshme edhe nese nje pjese e dokumentacionit te saj mund te jete ne gjuhen shqipe dhe nje pjese ne gjuhen angleze.

Ne DST Seksioni 4: Procedura, ne piken 4.7 nga ana juaj eshte percaktuar:

Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip X
Anglisht X

Gjuha per hartimin e ofertave (dokumentat) per kete procedure prokurimi ne perputhje me Ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe ne VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duhet te jetë shqip dhe anglisht.

Nisur nga sa me siper kerkojme nga Autoriteti Kontraktor qe pika 2.3.6 e kritereve te vecanta te kualifikimit te behet:

? Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për tregëtimin e artikujve të ofruar. Ne rast se operatori ekonomik eshte vet prodhuesi duhet te paraqese vetdeklarim me shkrim..

? Te hiqet termi i perkthyer dhe i noterizuar....

? Te percaktohet nga AK qe Gjuha per hartimin e ofertave (dokumentat) per kete procedure prokurimi do te pranohen shqip dhe anglisht.

Pretendimi nr.4.

? Konstatuam se në këtë procedurë mungon kriteri i paraqitjes se mostrave për të gjithë artikujt e ofruar, kriter ky që Autoriteti Kontraktor, Spitali Rajonal Durrës, në të gjitha procedurat e zhvilluara gjatë viteve të kaluara për të njëjtin objekt prokurimi – “Blerje materiale ortopedike” e ka përcaktuar si kriter të detyrueshëm që në momentin e dorëzimit të ofertave.

Kriteri i paraqitjes së motrave në këtë procedurë prokurimi ka një rëndësi të veçantë, pasi përmes mostrës:

? Verifikohet paketimi i produktit;

? Konfirmohet steriliteti, veçanërisht për artikujt që duhet të jenë 100% sterilë;

? Identifikohet origjina e produktit;

? Provohet përputhshmëria me standardin CE, si një garanci themelore për cilësinë dhe sigurinë e produktit.

Gjithashtu, mostra shërben si një element krahasues dhe verifikues ndërmjet të dhënave të katalogut teknik dhe produktit fizik të ofruar, duke mundësuar vlerësimin real të specifitimeve teknike dhe llojit të materialit të përdorur. Ky proces është thelbësor për mjekun specialist të fushës, i cili mbështet vlerësimin profesional në bazë të karakteristikave konkrete të produktit. Theksojmë se në të gjitha procedurat e mëparshme të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor për të njëjtin objekt, paraqitja e mostrave ka qenë gjithmonë një kërkesë standarde dhe konsistente. Për pasojë, heqja e këtij kriteri në një procedurë të re, pa ndonjë arsye të dokumentuar ose justifikim teknik, bie në kundërshtim me parimin e koherencës, të përcaktuar qartë në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Referuar ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, kriteret e një procedure prokurimi duhet të jenë koherente, objektive dhe të justifikuara.

Në këtë kontekst, Autoriteti Kontraktor ka detyrimin ligjor të ruajë vazhdimësinë dhe koherencën me praktikën e mëparshme, përveç rasteve kur ndryshimet janë të justifikuara dhe të dokumentuara qartë, sipas nenit 72 të ligjit nr. 162/2020.

Me qellim garancinë e cilësisë dhe përputhshmërisë me kërkesat teknike, kerkojme nga Autoriteti Kontraktor Spitali Rajonal Durres qe te shtoje si kriter paraqitjen e mostrave për të gjithë artikujt e ofertuar, pasi është një kriter teknik i rëndësishëm.

Me poshte po ju detajojme argumentat perse duhet te shtohet kriteri per paraqitjen e mostrave për të gjithë artikujt e ofertuar:

1. Verifikimi i përputhshmërisë me specifikat teknike:

Për të siguruar që artikujt e ofertuar përmbushin plotësisht kërkesat teknike të përcaktuara në dosjen e tenderit, është e nevojshme që për secilin artikull të dorëzohen mostra për vlerësim fizik

nga autoriteti kontraktor ose komisioni i vlerësimit.

2. Natyra sensitive e objektit të prokurimit:

Duke qenë se bëhet fjalë për produkte ortopedike, të cilat lidhen drejtpërdrejt me shëndetin dhe sigurinë e pacientëve, është jetike që të sigurohet që çdo artikull të jetë i përshtatshëm, funksional, i sigurt dhe në përputhje me standardet mjekësore. Mostrat ndihmojnë në këtë verifikim.

3. Reduktimi i rrezikut të furnizimit me produkte jo-konformë:

Në mungesë të mostrave, autoriteti kontraktor rrezikon të prokurojë materiale të cilat, ndonëse mund të përmbajnë certifikata ose deklarime, nuk përmbushin në praktikë kërkesat e nevojshme për përdorim klinik.

4. Lehtësimi i procesit të vlerësimit teknik:

Mostrat e dorëzuara ndihmojnë komisionin e vlerësimit të kuptojë më mirë karakteristikat teknike dhe ergonomike të pajisjeve, që shpesh nuk përshkruhen mjaftueshëm në dokumentacionin shoqërues.

Mostrat do të përdoren për të verifikuar përputhshmërinë me specifikat teknike të kërkuara dhe për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e materialeve ortopedike që do të prokurohen.

Perfundimisht kërkojmë nga AK modifikimin e dokumentave të tenderit (specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim) sipas kërkesës të detajuar më lart.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po ☐

Jo ☒

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

JO

7. Lista e informacionit konfidencial:

JO

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

finance@trimed.com.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Gentiana Peshkatari